



BASHKIA
TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Drejtuar: Bashkimit të operatorëve ekonomik “ZENIT&CO”& “FTA Studio” shpk

Adresa: Myrteza Topi, Ndertesa 18, Hyrja7, Apartamenti 38, Tirane.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” Loti I: “Mbikqyrja e punimeve për objektin “Rruga për tek Liqeni Çerkezës”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: *REF- 54745-12-22-2022*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rruga për tek Liqeni Çerkezës”.

Fondi limit: **573,754.24** (pesëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër pike njëzetetë e katër) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 6 (gjashtë) muaj kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.176 datë 27.12.2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Bashkimi i operatorëve ekonomik “ZENIT&CO”& “FTA Studio” shpk NUIS
K61731002D& L72411026N**

Vlera e ofertës = **478,839.93** (katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë pike nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “NET-GROUP” shpk NUIS L72023002P

Vlera e ofertës = **478,932.25** (katërqind e shtatëdhjetë e tete mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy pikë njezetë e pesë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “C.E.C GROUP” shpk NUIS L11807013M

Vlera e ofertës = **533,591** (pesëqind e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “S&L STUDIO” shpk

NUIS L61606040D

Vlera e ofertës = **545,066.5** (pesëqind e dyzetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë pesë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtem:

- **Operatori ekonomik “S&L STUDIO” shpk**

Operatori ekonomik “S&L Studio” shpk nuk përmbush piken 5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku përcaktohet *1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Nga verifikimi në formularin përmbledhës së vetëdeklarimit pjesa III pika B për disponimin e punonjësve rezultoi se nuk deklaroi 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”.*

Operatori ekonomik “S&L Studio” shpk nuk përmbush piken 7 të kriterëve të veçanta të kualifikimit në DST ku përcaktohet: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO”.* Nga verifikimi në SPE rezultoi se operatori nuk ka paraqitur ISO 39001-2012.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur informojmë bashkimi i operatorëve ekonomik **“ZENIT&CO”& “FTA Studio”** shpk, me adresë: Myrteza Topi, Nderresa 18, Hyrja 7, Apartamenti 38, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **478,839.93** (katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë pike nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, me adresë: *Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **478,932.25** (katërqind e shtatëdhjetë e tete mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy pikë njezetë e pesë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO



JO **X**